



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 486/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Vlastimir Dimic dhe Ferid Osmani, anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e Lëvizjes Vetvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

VENDIM

Hidhet poshtë ankesa si e palejuar e subjektit politik Levizja Vetvendosja kundër KQZ-së

Arsyetim

Lëvizja Vetvendosja (LVV) dega në Prishtinë ka parashtruar ankesë kundër Komisionit Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), duke pretenduar se më datë 12.12.2010 në shkollën fillore “Jeta e Re”, VV 2401A, në Suharekë në orën 19:10 është raportuar se janë 775 fletëvotime ndërsa në orën 19:50 është raportuar se janë 800 fletëvotime. Sipas parashtruesit të ankesës kjo mospërputhje e listës në vendvotimeve përbën shkelje të rëndë të procesit zgjedhor dhe manipulim votash.

Më 13 dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar nga LVV, duke pretenduar se në VV 2401 A në shkollën fillore “Jeta e Re” në Suharekë, ka pasur parregullsi në ditën e zgjedhjeve.

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, specifikon si me poshte:

59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji;

Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

6.4 *Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo at të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e palejuar

Ne baze te dispozitave te lartpërmendura, PZAP-i vlerëson se ankesa e LVV-se paraqitur kundrejt KQZ-së ne lidhje me mungesën e llampave identifikuese gjatë ditës se zgjedhjeve 12.12.2010, nuk është nen juridiksionin e tij.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Prandaj për këtë arsye dhe ne pajtim te dispozitave ligjore te cekura me larte si dhe ne pajtim te nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 486/2010 më datën 14.12.2010.



Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj